

community

The New Apostolic Church around the world

03/2016/AI



Të fitosh me Krishtin: Qëndrueshmëria është gjithçka

Shërbesë fetare në Angolë:
Blerë me një çmim të lartë

Nga katekizmi:
Doktrina e gjërave të
ardhshme

Nga historia e Krishtërit

New Apostolic Church
International



Qëndrueshmëria është gjithçka

Të dashur motra e vëllezër,

në letrat e Testamentit të Ri ne gjejmë shumë udhëzime, se si mund të fitosh me Jezusin.

Atje lexojmë edhe bilancin e jetës së apostul Palit: „Luftën e mirë e luftova, e përfundova vrapimin, e ruajta besimin. Pas kësaj më pret gati kurora e drejtësisë“ (krhs. 2. Timoteu 4,7-8). „Të fitosh“, e parë në aspektin e besimit, nuk do të thotë të jesh më i miri ndër të gjithë, përkundrazi do të thotë të ngulmosh dhe më në fund të arrish qëllimin tënd.

Letrat drejtuar Korintasve (9,25.26), Hebrenjve (12,1) dhe Filipjanëve (3,13.14) përmendin po kështu tabllonë e sportistit dhe të garës që ai bën. Këto tablo na ofrojnë ndihmë për të trajnuar qëndrueshmërinë tonë. Kush dëshëron të ngulmojë deri në qëllimin final, ai duhet pra

- ta dijë, ta njohë qëllimin, objektivin: Ne duam të hyjmë në lavdinë e përjetshme. Për këtë duhet t'i ngjasojmë gjithnjë e më shumë Krishtit. A merremi ne mjaftueshëm me këtë gjë?
- të mbajë në qëndër të vëmendjes qëllimin, objektivin: Le të mos na nxjerrin nga rruga që kemi nisur thirrjet ngazëlluese ose fyese që përjetojmë përgjatë rrjedhës së jetës.
- të ndajë rrugën në distanca: Nuk duhet të jetë dekurajues fakti, se jemi kaq larg natyrës, qënies së Jezusit. Ne mund të bëjmë here pas herë tonën një virtyt, një cilësi të vetme të tij, dhe të jetojmë për një fare kohe qëllimish, me vetëdije sipas saj.
- të ndajë forcat: Në se jeta e besimit është shumë për të, në se është rënduar, pra, të merret më pak me gjërat natyrore dhe të përqëndrohet tek ato shpirtërore.



NAC International

- të largojë rëndësën: faji dhe mospajtimi e vështirësojnë ecjen përpara, e bëjnë të vështirë progresin. Le ta kërkojmë faljen e fajëve dhe le të falim edhe ne, le të dhurojmë vetë falje!
- të mbajë dietë: Cili ushqim na forcon për vrapimin, për garën në besim? Le t'i japim shpirtit atë ushqim që e forcon atë për një kohë të gjatë, përgjithnjë. Kjo është veçanërisht: Fjala e Perëndisë dhe Darka e shenjtë.

Të marr pjesë është gjithçka – ky është motivi i njohur olimpik. Ndërsa për garën e besimit vlen: Të qëndrosh është gjithçka. Le të na mbushë me gëzim thirrja nga 1. Timoteu 6,12: „Lufto luftën e mirë të besimit; arrije jetën e përjetëshme, për të cilën ju u thirrët.“

Përsëndetje të përzemërta, juaji

Jean-Luc Schneider



Foto: Hermann Bethke dhe ENA Angola

Blerë me një çmim të lartë

1Korintasve 7,23

Jeni blerë me një çmim të lartë.

Të dashur motra e vëllezër, kënga e korrit është një shprehje e gëzimit tonë që kemi sot mundësinë për të përjetuar këtë shërbesë fetare. Unë e ndaj këtë gëzim me ju. Por mund ta marr me mend, se ka midis nesh ka edhe motra e vëllezër që nuk janë aq të gëzuar; jo sepse nuk mund të besojnë, por sepse ecin përmes provave, kanë tepër halle dhe shqetësohen shumë për të ardhmen e tyre ose për atë të fëmijëve të tyre. Unë dua t'iu them këtyre motrave e vëllezërve: Motër, vëlla, ti nuk je i harruar, Perëndia dëshiron sot të të ngushëllojë dhe forcojë. Ai do të të dhurojë afërsinë e tij në mënyrë që të ndjesh: Perëndia është shumë pranë meje. Ai të siguron ty ndihmën e tij.

Ndihma më e madhe, të cilën Perëndia dëshiron të na e japë, është çlirimi nga gjithshka e keqe. Kjo është shumë më tepër se sa të çlirohesh nga një sëmundje e momentit. Ai do të kujdeset, që të jemi përjetësisht të shpëtuar nga çdo vuajtje, nga çdo e keqe dhe e ligë. Prandaj ngushëllohu: Perëndia punon për të të ndihmuar ty.

Kjo punë ka filluar kur Biri i Perëndisë dha jetën e tij për ne. Për këtë foli Pali kur tha „Ju jeni blerë me një çmim të lartë.“

13.800 pjesëmarrës u mblodhën për shërbesën fetare në Basketball-Stadion „Cidabela“ dhe në sallën ngjitur.



Nga rënia e Adamit në mëkat, të gjithë njerëzit u bënë skllëvër të mëkatit. Ne vuajmë nga e keqja pasi jemi të ekspozuar ndaj pushtetit së saj. Të gjitha sëmundjet, padrejtësitë, vuajtjet dhe vdekja janë një pasojë e mëkatit. Që me lindjen e tij, njeriu është skllav i mëkatit. Zoti dëshiron të na shpëtojë prej kësaj. Për këtë, ai për ne ka paguar një çmim të lartë. Ai dha jetën e tij, u dënua në vendin tonë, u ekzekutua dhe u vra. Ai, që ishte i përsosur, i cili nuk kishte bërë kurrë një gabim, e mori mbi vete të dënohej, që të mos dënoheshim ne. U dënua që të mos dënoheshim prej gabimeve e mëkateve tona. Ne mund të shpëtohem prej meritës së tij.

*Ne nuk duam të ecim
sipas rrugës tonë,
ne ndjekim pas Jezu
Krishtin. E dimë: Ai që
lufton me Jezu Krishtin,
do të fitojë.*

Kaq shumë na do Perëndia, sa që biri i tij vdiq për ne. Gjithashtu le të mos harrojmë se çfarë bëri Perëndia pas sakrificës të birit, me qëllim që të arrinim në shijimin e kësaj merite. Ai dërgoi Shpirtin e shenjtë, dha apostujt, u kujdes

që të vazhdonte të dëshmohej Ungjilli i Jezu Krishtit gjatë gjithë këtyre shekujve. Ka pasur kohë, ku shumë njerëz kanë pranuar Ungjillin; por ka pasur edhe kohë të tjera, kohë, në të cilat të krishterët persekutoheshin e përsëri Perëndia është kujdesur, që ai të vazhdojë më tej.

Ne kujtojmë po ashtu të gjithë ata njerëz, të cilët janë kujdesur që ne sot të mund ta njohim mesazhin e Ungjillit. Jezu Krishti ka paguar për ne një çmim të lartë dhe shumë



njerëz në shërbim të tij kanë sakrifikuar që ne tani të mund të shpëtohem. Sa sakrificat janë dashur që puna e apostujve të mund të veprojë tashti midis nesh!

Pali thotë: „Ju jeni blerë me një çmim; mos u bëni skllavër të njerëzve.“ Kjo nuk ka të bëjë me një person në veçanti, por këtu është marrë parasysh skllavëria e botës: Perëndia ju ka shpëtuar, ka paguar shtrenjtë që të mos bëheni përsëri skllavër të botës. Thuhet madje „Skllavër të njerëzve“. Skllavi nuk është i lirë, ai është i varur. Vullneti i lirë nuk vlen më, ai duhet të bëjë atë çfarë i thotë i zoti i tij.

Është i detyruar të punojë dhe nuk merr asnjë shpërblim për këtë, gjithshka bëhet më kot. Ne, si fëmijë Perëndie, nuk duhet të bëhemi më skllavër të botës. Çfarë do të thotë kjo?

Në bibël ekzistojnë shumë shembuj për njerëz, të cilët

ishin zgjedhur ose blerë, e përmes një vendimi të gabuar humbën gjithshka. Kujtoni Esaun. Ai ishte i zgjedhur, ishte i parëlindur, duhet të merrte një bekim të veçantë; por ai ishte i robëruar prej nevojave të tija tokësore. Ngaqë ishte i robëruar nuk mund të vendoste lirisht. Ai shiti bekimin për një pjatë me thjerza. Për të, gjërat tokësore ishin më

të rëndësishme se sa bekimi. Prandaj u bë skllav i vëllait të tij. Pyetjes së djalit, nese nuk do të kishte më bekim për të, babai iu përgjigj: „E kam emëruar“ – vëllain tënd – „sundimtar mbi ty; të gjithë vëllezërit e tij duhet t'i shërbejnë ... çfarë mund të bëj për ty, biri

*Ai që ndjek pas Jezu Krishtin
nuk e bën më kot, ai do të marrë
kurorën e jetës së përjetshme,
shpërblimin më të madh që mund
të ekzistojë.*

im?“ (Zanafilla 27,37).

Ekziston një rrezik i madh, që të bëhemi skllavër dhe robër të nevojave tona tokësore dhe mirëqënia jonë tokësore të bëhet më e rëndësishme se sa shërimi i shpirtit. Disa pastaj





Predikimin e plotësuar apostuli i distriktit Patrick Mkhwanazi (Afrika Juglindore, foto lart djathtas) dhe apostuli i distriktit Noel E. Barnes (Cape)



thonë: „Nuk mund të vi në sherbesë fetare, duhet të kujdesem për punën time.“ Të tjerë thonë: „Nuk mund t'i bindem Perëndisë, unë nuk mund të jetojë sipas urdhëresave kur bëhet fjalë për para.“ Ata kanë vendosur nëpërmjet pagëzimit me Ujë të Shenjtë, marrjes së Vulës së Shenjtë e konfirmacionit që të ecin sipas Jezusit e të jetojnë sipas urdhëresave të Perëndisë. Por, pasi u bënë skllëvër të gjërave tokësore nuk janë më të lirë dhe nuk mund ta mbajnë më pohimin e tyre. Ata nuk i respektojnë më urdhëresat, për shkak të nevojave të tyre tokësore.

Jemi blerë me një çmim të lartë. Të mos bëhemi përsëri skllëvër të gjërave tokësore. Ne kemi vendosur për Perëndinë dhe jemi të lirë, ecim në rrugën që ka vendosur Perëndia.

Apostul Pali ka bërë të qartë, se për shërimin, shpëtimin e shpirtit nuk është e rëndësishme nëse je skllav apo njeri i lirë, nëse çifut ose jo, i pasur ose i varfër. Ajo varet vetëm nga qëndrimi ynë. Le të kemi qëndrimin e duhur të zemrës sonë. Ne nuk duam të udhëhiqemi nga nevojat tona tokësore.

Një shembull tjetër nga Testamenti i Vjetër është historia e Sansonit, gjykatësit të Izraelit. Nëna e tij, kur ai erdhi në jetë, ia përkushtoi atë Perëndisë. Këtë njeri Perëndia e kishte

përzgjedhur që të luftonte kundër filistejve, kundërshtarëve të Izraelit. Atëherë ishte kështu, kur dikush i dedikohet Perëndisë, kur ai qëndronte në shërbim të tij, nuk i lejohej të priste flokët. Të gjithë e dinin: nëse vjen dikush me flokët të gjatë, atëherë ky është një i dedikuar i Perëndisë, një shërbëtor i tij. Po kështu edhe këtij nuk i lejohej të priste flokët (1i Samuelit 1,11).

Sansoni ishte shumë i fortë dhe luftonte kundër filistejve. Një ditë ai njohu Delilan dhe kjo grua u korruptua prej filistejve. Princat e Filistejve erdhën tek ajo dhe i thanë: „Vëzhgoje me kujdes që të zbulosh ku i ka forcat Sansoni dhe të marrësh vesh çfarë duhet të bëjmë që ta shtiem në dorë dhe ta lidhim. Për këtë do të marrësh prej nesh 1100 monedha argjendi.“ Delia e bezdiste shpesh Sansonin: „Më thuaj pra ku qëndron forca jote e madhe!“ Pas disa kohësh Sansoni u dorëzua për t'i pëlqyer asaj, dhe i tha: „Gjatë



majtas: apostuli kryesor Jean-Luc Schneider emëron apostul kryeplakun e distriktit José Calenga Baza (i gjunjzuar) dhe nxjerr në pension apostulin Alfonso Avelino (në këmbë) pas 30 vjet aktivitet pune

gjithë jetës sime nuk i kam qethur flokët asnjëherë. Që kur kam lindur i jam shuguruar Zotit. Në qoftë se më qethen flokët, do t'i humbas forcat dhe nuk do të jem më i fortë se njerëzit e tjerë“ (Gjyqtarët 16,5–17). Thënë ndryshe: Forca e tij qëndronte në lidhjen e tij të ngushtë me Perëndinë. Çfarë bëri gruaja? Ajo ia preu kaçurelat Sansonit. Ajo pra, ia mori shenjë e lidhjes së tij me Perëndinë. Sansoni u bë i dobët, u zu rob dhe u bë skllav i filistejve. Përse? Pasi mori vendimin e gabuar. Kënaqësia e kësaj gruaje ishte për të më e rëndësishme se sa kënaqësia e Perëndisë.

Ne përpiqemi, ta gjejmë vendin tonë në shoqëri dhe të kujdesemi për marrëdhënie të mira me bashkëkohësit tanë. Por, marrëdhënia me njerëzit nuk duhet të bëhet më e rëndësishme se sa ajo me Perëndinë. Ne duam t'i pëlqejmë më shumë Perëndisë. Ndonjëherë duhet të themi: „ Jo, nuk bashkohem me ty, edhe pse nuk të pëlqen. Nuk do ta bëj këtë, sepse kënaqësia e Perëndisë është më e rëndësishme për mua.“

Një shembull i tretë nga Testamenti i Vjetër: Izraeli ishte populli i zgjedhur i Perëndisë. Kjo natyrisht nuk ju pëlqente popujve të tjerë. Edhe një herë erdhën filistejtë dhe luftuan popullin e Perëndisë. Armiqtë kishin me vete një burrë të madh, ai ishte Golias, një gjigand me armë të rënda, përpara të cilit të gjithë frikësoheshin. Ai përqueshte Izraelitët, tallej me Perëndinë dhe thoshte: „Zgjidhni një burrë që të dalë kundër meje. Në rast se do të jetë në gjëndje të luftojë me mua dhe të më vrasë, ne do të jemi shërbëtorët tuaj; por në rast se dal unë fitues dhe e vras, atëherë ju do të jeni shërbëtorët tanë dhe do të na shërbëni“ (1. Samuel 17,8.9). Izraelitët kishin frikë, dhe prej frikës gati do të ishin bërë skllavë të armiqve të tyre. Për fat erdhi Davidi i vogël, i cili nuk frikësohej. Ai e dinte: Me Perëndinë kish mundësi ta

mundte Golias. Davidi e liroi popullin e tij.

Edhe ne mendojmë ndonjëherë se jemi të dobët e shpirti i keq, ai tokësori është aq i fuqishëm. Teoritë e tia përhapen me një forcë të madhe. Ata që e ndjekin pas atë, janë kaq të suksesshëm, kurse ne kemi nganjëherë në jetën tonë kaq shumë mundim. Djalli ka shumë mjete në dispozicion, ne nuk mund të mbrohemi fare prej tij! — Kjo nuk është e vërtetë! Edhe në qoftë se armiku ynë është shumë i fuqishëm, ne e dimë: Me Krishtin mund të fitojmë! Krishti është më i fortë se armiku i tij! Ne ndjekim Jezu Krishtin, dhe luftojmë kundër së keqes. Me të ne do të fitojmë. Ne nuk duam të bëhemi skllavë të së keqes.

Një shembull tjetër, që e ka dhënë vetë Jezusi. Ai u tregoi dishepujve një shembull dhe u tha: „Kur një shpirt i keq del nga një njeri, shkon nëpër vende të shkreta, duke kërkuar një vend, ku mund të pushojë. Në qoftë se nuk mund ta gjejë, thotë me vete: Do kthehem në shtëpinë time nga e cila dola. Prandaj kthehet dhe e gjen shtëpinë të pastruar dhe të rregulluar. Pastaj shkon e merr me vete shtatë shpirta të tjerë, më të këqij se vetja, dhe ata hyjnë e banojnë atje. Kështu gjëndja e fundit e këtij njeriu bëhet më e keqe se e para“ (Luka 11,24–26). Ky shembull na thotë diçka.

Me anë të pagëzimit tonë me Ujë e nëpërmjet marrjes së Vulës së shenjtë ne u pastruam. E keqja u dëbua, nuk kishte më asnjë të drejtë mbi ne, ne i takojmë Jezu Krishtit. Tani na përket ne vendimi se kush do të banojë në zemër tonë. Shpirti i lig me shtatë shoqëruesit e tij mundi të kthehej përsëri, pasi zemra ishte bosh, kishte vend.

Ne duam të kujdesemi që Shpirti i shenjtë të jetojë në zemrën tonë dhe ta mbushë të gjithë zemrën, po madje të gjithë



Pas shërbesës fetare apostuli kryesor Schneider ju jep një konferencë shtypi mediave lokale

Këto janë shembuj të thjeshtë të njerëzve, të cilët Perëndia i kishte zgjedhur për t'i bekuar, por që kanë marrë një vendim të gabuar. Ata u bënë përsëri skllëvër të njerëzve.

Ne duam të jemi shërbëtorë dhe shërbëtores të Krishtit. Nga dashuria për Jezun Krishtin jemi të lidhur shumë ngushtë me të. Nuk duam të ecim në rrugën tonë, ne ndjekim pas Jezun Krishtin. Ne e dimë: ai që lufton me Jezun Krishtin do të fitojë. Ai që ndjek pas atë, nuk e bën më kot, ai merr kurorën e jetës së përjetshme, shpërblimin më të madh që mund të ekzistojë. Meqë është paguar një çmim i lartë për ne, le të jemi me të vërtetë nxënë, shërbyes, skllëvër të Jezun Krishtit. Shpërblimi do të jetë papërshkrueshmërisht i madh.

jetën tonë. Krijesa e re në Jezun Krisht duhet të shpalojë brënda nesh. Kur jeta nga Shpirti i shenjtë e mbush të gjithë zemrën, shpirtat e tjerë nuk kanë më vend atje. Por, kur një njeri pagëzohet, merr Vulën e shenjtë dhe zemra e tij nuk është e plotësuar prej Shpirtit të shenjtë, atëherë shpirtat e lig kthehen përsëri dhe ky njeri bëhet shumë i pakënaqur.

Pastaj te njeriu kthehet shpirti që i erdhi edhe Jezusit në tundim e i thotë: „Përdore pra birësinë tënde hyjnore për të pasur një jetë më të mirë në tokë.“ Njeriu vjen në shërbesë fetare, por dikujt i intereson veç jeta tokësore: „I dashur Zot, bëj që të jem më mirë. I dashur Zot, unë jam fëmija yt, bëj që të bëhem i pasur.“ Shpirti i vjetër është rikthyer përsëri, dhe ai vendos se çfarë do të lutemi, se çfarë duhet të bëjmë. Një njeri i tillë, është në gjëndje të keqe, pasi kupton: Nuk po funksionon, jam apostolik i ri por nuk po pasurohem. Ai është më keq se më parë.

Je pagëzuar, ke marrë Vulën e shenjtë, zemra u pastrua, u shenjtërua por nuk lejon që Shpirti i shenjtë të shpalojë si duhet.

Një shembull tjetër: Njeriu në bashkësi kërkon të jetë dikushi. Atëherë bëhet fjalë vetëm për të dalë në pah, për t'u dukur në kishë ose nëpërmjet saj. Njeriu këndon në korr, por jo për të lavdëruar Perëndinë, porse vetëm për t'u dukur. Dhe vëllai bën gjithshka për të pasur një post më të lartë, ai do të bëhet shef. Ai është bërë skllavi i një shpirti, nuk i shërben më Perëndisë. Ai dëshiron të punojë për të mirën e tij. Çdo gjë që ai bën, e bën me paramendim. Njëri do të bëhet i pasur, tjetri do të duket. Këta njerëz bëhen skllëvër të një shpirti dhe nuk marrin atë çfarë duan; dikur do të zhgënjehen.

Mendime kyçe, kryesore

Të blerë prej sakrificës së Krishtit ne duam të kujdesemi që

- të mos jemi skllëvër të gjërave tokësore,
- t'i pëlqejmë më shumë Perëndisë se sa njerëzve,
- të mos lejojmë të impresionohemi prej fuqisë të së keqes,
- t'i mundësojmë Shpirtit të Shenjtë ta mbushë të gjithë zemrën tonë.

| Zhvillim, jo përsëritje

Nuk ka asnjë dyshim: Drita zhvendos natën. Dhe dita e Zotit do të agojë. Kjo do të thotë që: të zgjohesh në kohë dhe të bësh gjënë e duhur. Pikat kryesore nga shërbesa fetare e apostulit kryesor në Astana/Kazakistan.

Fotot: NAK Berlin-Brandenburg



Qoftë në historinë e Krijimit apo në lindjen e Jezusit, qoftë në lirin e Pjetrit apo në konvertimin, në kthimin e Palit: „Aty ku Perëndia është prezent, aty ku ai vepron, aty ka dritë; aty ka qartësi; aty ka vërtetësi, siguri, ka jetë“, kështu tha apostuli kryesor. „Këtë tablo e gjejmë shumë shpesh në Bibël.“

Tablloja e ditës, e cila ndjek, pason natën, duhet të na bëjë më të qartë se rikthimi, ardhja e Zotit është e pandalshme: „Edhe kur nata është shumë e errët dhe e gjatë, gjithkush e di se: errësira nuk mund të ndalojë agimin e ditës. Dita do të vijë, e kjo është absolutisht e sigurt.“

Paralajmërim dhe alarm

Me këto është e lidhur një thirrje, një apel: „Ti duhet të zgjohesh.“ Pali e bën këtë thirrje në rreshtin 11. Apostuli kryesor Schneider shikon këtu dy aspekte:

Kush është në gjumë, kush fle nuk tregon asnjë reaktion: „sa herë që dëgjojmë, se Zoti do të vijë së shpejti, duhet të reagojmë. Le të jemi të zellshëm: „Duhet të përgatitem, çfarë duhet të bëj?“

Kush është në gjumë, kush fle nuk i sheh, nuk i dallon rreziqet: „Kur ne mendojmë se: „Unë jam pagëzuar tashmë, kam marrë Vulën, marr pjesë në çdo shërbesë fetare, jam atje,... atëhere jemi në rrezik.“ Pasi: „besimi ynë nuk është një besim sa për traditë. Nuk bëhet fjalë këtu për të përsëritur përjetësisht të njëjtën gjë, porse për t'u zhvilluar, për t'u bërë ndryshe, njeri krejt tjetër.“

Veprat dhe armët

Dy thirrje të tjera për veprim përmenden në rreshtin 12 të letrës drejtuar Romakëve: të flakësh veprat e errësirës dhe të veshësh armët e dritës.

„Vepra të errësirës janë të gjitha ato gjëra, të cilat i bëjmë

në fshehtësi“, sqaroi apostuli kryesor: „Ne nuk duhet të pastrojmë vetëm veprat, të bërat tona. Ne duhet të pastrojmë edhe mendimet tona. Le të dalim fitues edhe mbi mëkatet e fshehta, mbi ato që nuk na i di askush, nuk na i sheh askush. Ato janë para Zotit po kaq të rëndësishme, si ato të tjerat.“

Armët e dritës mund t'i përdorim si për mbrojtje ashtu edhe për sulm:

Le t'i bëjë ballë besimi ynë mendimit, se Zoti na ka harruar: „edhe kur jemi të zhytur thellë në errësirën e natës, le të nxjerrim armët e dritës dhe t'i themi të ligës, të keqes: „Unë besoj fort – se Perëndia më do!“

„Dashuria është e vetmja armë që nuk vret, nuk lëndon askënd por gjithnjë fiton.“ Ajo shërben për t'u mbrojtur, „kur sulmohemi nga dobësia e tjetrit, e të afërmit“. Dhe: „po me këtë armë ne luftojmë për shpëtimin, për çlirimin e tjetrit, të afërmit.“

Shpresa luftoftë dekurajimin: „Ne përqëndrohemi te lavdia e ardhshme. – Ne luftojmë për çlirimin, për shpëtimin e shpirtit tonë, pasi e dimë mirë që gjithnjë ja vlen.“

„Ne mbrohemi dhe njëkohësisht luftojmë të ligën, të keqen me besimin, dashurinë dhe me shpresën“, tha në fund apostuli kryesor: „Fitoren e kemi të sigurt. Kush lufton me Krishtin në zemër, fiton gjithnjë.“



Pritje për të nxitur dialogun paqësor: Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider takohet mbas shërbesës fetare me përfaqësues të administratës shtetërore, me përfaqësues të kishave të tjera dhe me përfaqësues të fesë islame.



JEZUSI LUTET NË KOPSHTIN GATSHEMEN.

(MARKU 14,26–43)

Gjatë festës së Pashkës Jezusi ndau darkën e fundit me dishepujt e tij. Jezusi e di se së shpejti do të tradhëtohet dhe se duhet të sakrifikohej. Me dishepujt e tij ai shkoi në malin e ullinjve.

Gjatë rrugës për në kopshtin Gatshemen, Jezusi u thotë nxënësve: „Edhe disa orë dhe të gjithë do të më braktisni. Madje edhe një profet para shumë kohësh ka parashikuar se delet do të largohen nga

njëra-tjetra kur të vritet bariu. Por unë pas vdekjes time do të ringallem dhe do t’ju shfaqem.“ Pjetri kundërshtoi: „Edhe sikur të gjithë të tjerët të dështojnë, unë nuk do të të braktis.“

Jezusi i thotë: „Përpara se sot në darkë të këndoje gjeli dy herë, ti do të pretendosh tre herë se nuk më njeh.“

Pjetri thërret: „Më mirë do të vdisja me ty, se sa ta bëja këtë gjë.“

Nxënësit e tjerë i japin Pjetrit të drejtë.

Kur arrijnë në kopshtin Gatshemen, Jezusi u thotë nxënësve të tij të ulen gjatë





kohës që ai lutet. Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin ai i merr me vete.

Jezusi është i trishtuar për vdekje. Të treve ai iu thotë: „Rrini zgjar dhe lutuni.“

Dhe ai shkon pak përpara, bie përmbys përtokë dhe lutet: „At, nëse është e mundur, atëherë largoje prej meje këtë kupë vuajtjesh. Por nuk duhet të ndodhë ajo çfarë dua unë, por ajo çfarë do ti.“

Kur ai kthehet përsëri, i shikon nxënësit në gjumë.

Ai zgjon Pjetrin: „Po fle? Nuk mund të qëndrosh zgjuar vetëm për një orë? Qëndroni zgjuar dhe lutuni.“

Jezusi largohet sërisht pak më tej dhe lutet me të njëjtat fjalë. Kur kthehet edhe një herë,



nxënësit i kishte zënë sërisht gjumi. Sytë e tyre ishin rëndurua dhe ata nuk dinin çfarë t'i përgjigjeshin.

Jezusi lutet për të tretën herë vetëm dhe prap Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin i zë gjumi. Ai i zgjon dhe iu thotë se ka ardhur ora, në të cilën do të tradhëtohet.

Aty po afroreshin Juda tradhëtari me një turmë të madhe njerëzish të armatosur për të arrestuar Jezusin.

Gatshemen do të thotë shtrydhëse ose shtypëse vaji. Është një kopësht me shumë pemë ulliri. Ai shtrihet jashtë Jeruzalemit, rrëzë malit të ullinjve.



PER VIZITË TEK ELBERT NË YOGYAKARTA (INDONEZI)



Fotot: privat

Unë quhem Elbert dhe jam njëbmëdhjetë vjeç. Unë jetoj në Yogyakarta në ishullin indonezian Java. Unë jam më i vogli i tre vëllezërve, dy vëllezërit e mi janë 22 dhe 18 vjeç.

Çdo ditë unë shkoj me biçikletë në shkollë, për

fat të mirë ajo është veç disa qindra metra nga shtëpia. Unë jam në klasë të pestë, më shumë nga të gjitha më pëlqejnë shkencat natyrore. Një herë në javë unë shkoj edhe në mësimin e violinës me biçikletë.



Menjëherë mbasdite bëj detyrat e shtëpisë, pastaj ndihmoj nënën time për punët e shtëpisë. Hobet e miya janë të luaj me violinë dhe të lexoj. Mua më pëlqejnë libra për njerëz të famshëm.



Të dielën në mëngjes unë shkoj në shkollën e së dielës, aty kam shumë shokë. Në kishë më pëlqen të këndo. Ndonjëherë shoqëroj korrin gjatë shërbesës fetare me violinën time.



Babai im shërben në kishë si apostul. Unë e dua shumë atë dhe lutem gjithmonë për të kur ai është në udhëtim. Ndonjëherë më lejohet edhe mua të shkoj bashkë me të, si për shembull në bashkësinë Kedoya në Jakarta. Shpesh në bashkësitë indoneziane nuk ka organo, në vend të saj luan një orkestër – Anklungu (një instrument tipik indonezian që bëhet me shkopinj bamboje të varur në një kornizë).



Gjatë gjithë vitit unë gëzoj për ditët e fëmijëve. Atje takoj shumë fëmijë të tjerë dhe mund të luaj me ta. Pasi babai im është përgjegjës për shumë distrikte, mua më lejohet të marr pjesë në ditën e fëmijëve në Yogyakarta, në Javën perëndimore, në Jakarta dhe në Pantai Utara Java. Te fotot ju mund të shikoni se sa shumë argëtohem.

Në Yogyakarta vijnë një numër i madh turistësh por edhe shumë studentë nga e gjithë Indonezia, pasi këtu ka disa universitete. Drejte në qytet mund të vizitosh Pallatatin e Sulltanit. Po të udhëtosh afërsisht 30 kilometra drejt veriut mund të shikosh malin Merapi, ky është vullkani më aktiv i botës. Rreth 40 kilometra në jug të Yogyakartaës ka plazhe të mrekullueshme. Unë shkoj shpesh në plazh.

Ushqimi im i preferuar është Nasi Goreng Java, oriz i pjekur sipas mënyrës javaneze, ose Magelangan, një përzierje e orizit të pjekur dhe makaronave. Këtë e shoqëroj me çaj Ingver.

Gjatë pushimeve unë shkoj për vizitë të xhaxhai im në Jakarta, në kryeqytetin e Indonezisë. Aty ka gjëra shumë interesante për t'u parë. Një herë isha në kopsh-tin botanik. Kësaj i takon edhe një park shpendësh me zogj të jashtëzakonshëm. Njëri më fluturoi deri mbi supe, kjo gjë ishte shumë emocionuese!





Foto: © zhu difeng - Fotolia.com

Doktrina e gjërave të ardhshme

Në shtator 2015 u botua katekizmi i Kishës Apostolike të Re me pyetje e përgjigje. Nga gjithsej 750 pyetje e përgjigje, community do të paraqesë në mënyrë të pjesshme disa prej tyre – në këtë botim behët fjalë për „Doktrinën e gjërave të ardhshme“ dhe „Nga historia e krishterimit“

Cila ngjarje e ardhshme është qëllimi i besimit i të krishterëve apostolikë të rinj?

Jezu Krishti do të vijë përsëri – ky është mesazhi kryesor i Ungjillit. Që me ngjitjen e tij në qiell apostujt shpallin kthimin e Zotit. Të pranohemi prej tij në këtë ngjarje, është qëllimi i besimit i të krishterëve apostolik të rinj.

Kush e ka premtuar rikthimin e Jezu Krishtit?

Vetë Jezu Krishti u premtoi apostujve të tij: „Po shkoj, pra, për t’ju përgatitur një vend. Pastaj do të kthehem për t’ju marrë me vete, që edhe ju të jeni atje ku do të jem unë“ (Gjoni 14,3). Ky premtim gjatë ngjitjes së tij në qiell u përforsua nga engjëjt: “Ky Jezus, që u mor në qiell, do të kthehet pikërisht kështu, siç e patë duke u larguar prej jush“ (Vep. e apost. 1,11).

Kush e di kohën e rikthimit të Krishtit?

Se në cilën ditë dhe në cilën orë do të kthehet përsëri Jezu Krishti nuk e dinë as njerëzit dhe as engjëjt, por vetëm Trinia e Perëndisë.

Çfarë do të thotë për ne premtimi i rikthimit të Krishtit?

Që Jezu Krishti do të kthehet përsëri e do të marrë pranë vetes bashkësinë nuse është një nga siguritë themelore të Ungjillit. Ai vetë e premtoi rikthimin e tij (krhs. Gjoni 14,3).

Pse besojmë ne, se rikthimi i Krishtit është afër?

Që posti i apostujve është zënë përsëri është një shenjë se rikthimi i Krishtit qëndron afër. Pritshmëria që ky premtim i Zotit të realizohet, qëndron sot në qendër të besimit apostolik të ri, ashtu si edhe shpresa e çdo njeri për ta përjetuar personalisht rikthimin e Krishtit dhe ngjitjen drejt tij.

Si realizohet përgatitja për rikthimin e Krishtit?

Apostujt i përgatisin besimtarët për rikthimin e Krishtit me anë të fjalës dhe shenjtërimeve. Këta e lidhin jetën e tyre me vetëdije me këtë

Çfarë ndodh në rikthimin e Krishtit?

Duke i përmbledhur këto deklarata të apostul Palit rezultojnë: Gjatë rikthimit të Zotit do të ringjallen në fillim të paprishur, të vdekurit që kanë vdekur në Krisht. Të gjallët, të cilët lejuan të përgatiteshin për kthimin e Krishtit do të përjetojnë transformimin pa vuajtur vdekjen trupore. Të vdekurit dhe të gjallët do të marrin një trup të lavdishëm. Ky trup i ngjason trupit të ringjallur të Krishtit. Ata do të ngjiten bashkërisht drejt Jezu Krishtit dhe do të arrijnë kështu në bashkimin e përjetshëm me Trininë e Perëndisë. Këto ngjarje bëjnë pjesë në ringjalljen e parë, për të cilat bëhet fjalë te Zbulesa 20,5.6.

Kush do të merret gjatë kthimit të Krishtit?

Marrja gjatë rikthimit të Krishtit u është premtuar fillimisht atyre që u është dhënë rilindja nëpërmjet ujit dhe shpirtit. Kjo tufëz është quajtur edhe „bashkësia nuse“ ose „biri“ (Zbulesa 12,5). Nese përtej kësaj, Perëndia ua jep edhe të tjerëve mëshirën e ngritjes drejt tij, kjo nuk është pjesë e gjykimit njerëzor, por i nënshtrohet vendimit të Perëndisë.

A ka ndonjë karakteristikë, ndonjë shenjë dalluese për ata që i përkasin bashkësisë nuse?

Po – një karakteristikë e dallueshme është se ata presin çdo ditë rikthimin e Krishtit dhe janë të qëndrueshëm në lutje: „Eja o Zot, sa më shpejt!“ (krhs. Zbulesa 22,17.20).

Cilat ngjarje përfshin ringjallja e parë?

Në ringjalljen e parë do të ngjallen „të vdekurit në Krisht“ dhe së bashku me të gjallët do të merren edhe ata që bëjnë pjesë në bashkësinë nuse. Pas „dasmës në qiell“ do të ringjallen martirët e „pikëllimit të madh“ dhe do të jenë pjesë e priftërisë mbretërore. Këto dy ngjarje përcaktohen si „ringjallja e parë“: „I lum dhe i shenjtë është ai që ka pjesë në ringjalljen e parë. Mbi ata vdekja e dytë nuk ka pushtet, por do të jenë priftërinjë të Perëndisë dhe të Krishtit dhe do të mbretërojnë me të për një mijë vjet“ (Zbulesa 20,6).

Çfarë ndodh pas përfundimit të ringjalljes së parë?

Pas përfundimit të Ringjalljes së parë Jezu Krishti do të vendosë në tokë mbretërinë e tij të paqes dhe do të ushtrojë për „një mijë vjet“ sundimin e tij mbretëror. Këta „një mijë vjet“ qëndrojnë si simbol për një kohë të gjatë, por të kufizuar.

Çfarë do të ndodh në tokë gjatë periudhës së mbretërisë së paqes?

Gjatë periudhës së mbretërisë së paqes të Krishtit, Jezu Krishti do të shpallë lirisht Ungjillin me priftërinë mbretërore. Ungjilli do ju jepet më pranë të gjithë njerëzve që jetojnë në tokë, si edhe të gjithë shpirttrave që kanë ndërruar jetë. Në fund të mbretërisë së paqes do ta kenë njohur Ungjillin të gjithë njerëzit e të gjithë kohërave.

Çfarë ndodh me ata që do të shkojnë në Gjygin e fundit?

Ata të cilët do të gjejnë mëshirë në gjygin e fundit, do të jenë – bashkë me ata që morën pjesë në ringjalljen e parë – banorë të krijimit të ri të Perëndisë. Të gjithë ata mund të kenë pastaj një bashkim të përjetshëm me Perëndinë. Të tjerët do të do të mbeten në mjerimin e ndarjes nga Perëndia.

Çfarë thuhet në Bibël mbi krijimin e ri të Perëndisë?

Perëndia, pas gjyqit përfundimtar, do të vendosë një krijim të ri në vend të të vjetrit: „Dhe ai [Perëndia] do të banojë me ta; dhe ata do të jenë populli i tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndi i tyre“ (Zbulesa 21,3). Me këtë plotësohet pritshmëria që shprehet te 2 Pjetri 3,13: „Por ne, sipas premtimit të tij, presim qiej të rinj dhe tokë të re, në të cilën banon drejtësia.“ Kjo mbretëri e Perëndisë do të jetë e përjetshme; atëherë Perëndia do të jetë gjithçka në të gjithën (krhs. 1 Korintasve 15,28).

Masthead

Publikuesi: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zyrh/Svicër
Shtëpia Botuese Bishoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Gjermani
Editori: Peter Johanning

| Nga historia e Krishtëritimit

Si u krijuan bashkësitë e para të krishtera?

Në Jeruzalem, e pikërisht në ditën e Pentakostit, e ardhjes së Shpirtit të shenjtë, u krijua bashkësia e parë e krishterë (krhs. Vep. e apost. 2,37 ff.), e cila përbëhej vetëm nga hebrenj, judenj. Për shkak të përndjekjes, shumë besimtarë u larguan nga Jeruzalemi (krhs. Vep. e apost. 8,1; 11,19). Në mjedisin e tyre të ri ata shpallën Ungjillin, i cili u besua edhe atje. Kështu u krijuan në shumë vende bashkësitë e krishtera.

Si u zhvillua Krishtërimi mbas shek. të dytë?

Ajo urrejtje, e cila filloi me vrasjen me gurë të diakon Stefanit, u rrit e u zhvillua në një dallgë të madhe përndjekjesh: Shumë të krishterë u vranë për shkak të besimit të tyre. Për këtë ata u kthyen në Martirë. Me gjithë përndjekjet dhe pengesat e shumta, besimi i krishterë u përhap shumë dhe u shtri në të gjithë Perandorinë romake.

Si eci zhvillimi i krishtëritimit deri në Mesjetë?

Në kohën e migrimit të popujve (Shek. 4./5.) Krishtërimi u fuqizua shumë në Evropë dhe në Azi. Në këtë përhapje, në këtë shtrirje të krishtëritimit një rol të madh luajti edhe Monasticizmi, i cili u krijua në shek e 3-të në fillim në Egjipt. Një nga detyrat më kryesore të murgjërve ishte, që të jetonin në varfëri, ashtu siç jetoi Krishti dhe që të përhapnin besimin e krishterë kudo. Murgjit dhe murgeshat, në Mesjetë, kanë arritur rezultate të shumta e të rëndësishme në shkencë, ata u angazhuan në fushën e bujqësisë si dhe në çështjet sociale. Krishtërimi përcaktonte gjithnjë e më shumë jetën e njerëzve si dhe kulturën, politikën dhe shoqërinë në Evropë. Në vitin 1054 u bë një ndarje në një Kishë Perëndimore (katolike romake) dhe në një Kishë Lindore (ortodokse).

Me çfarë iu desh të krishterëve të merren më shumë mbas shek të 7-të?

Mbas shek. të 7-të të krishterëve iu desh të merreshin me një besim të ri, me Islamin në pjesë të ndryshme të Azisë, Afrikës madje edhe të Evropës. Besimi i krishterë humbi shumë rajone, si p.sh. Lindjen e Afërme dhe Afrikën e Veriut. Ka pasur beteja të tilla si p.sh. gjatë Kryqëzatave. Ato kanë ndodhur nga viti 1095 dhe 1270 në Orient, në Lindjen e Afërme dhe patën për qëllim të rimerrnin, të zotëronin

Jeruzalemin dhe tokën e bekuar për krishtërimin.

Përse u bënë përpjekje për të reformuar kishën?

Në Mesjetë u shfaq në brendësi të kishës laicizmi, kisha brenda saj u bë gjithnjë e më shumë laike – besimi dhe doktrina humbën vlerat e tyre. Kjo erdhi si rezultat i një mangësie të përqëndrimit tek Ungjilli. Për këtë arsye u bënë përpjekje për të reformuar kishën. Nga njëra anë përpiqej Monasticizmi, murgjërit për një reformë, nga ana tjetër njerëz, burra të dëgjuar si francezi Petrus Waldes (1140 - 1218), teologu anglez Johannes Wiclif (1330 - 1384) dhe Rektori i Universitetit të Pragës, Johannes Hus (1369 - 1415). Këta të gjithë qenë kritikues të kishës laike. Këto lëvizje, të nxitura e të shoqëruara prej këtyre njerëzve, i mbështetën edhe pjesë të tjera të Evropës dhe ato së fundi çuan në Reformim.

Çfarë është Reformimi?

Reformimi (në latinisht „reformatio“: restaurim, ripërtëritje) është një lëvizje ripërtëritje fetare në Evropë, e cila është bazuar në dëshirën për një rikthim në Ungjillin. Ajo lidhet ngushtë me murgun gjerman Martin Luther (1483 - 1546). Sipas bindjes së tij, e vetmja bazë për mësimin, për doktrinën, duhet të ishte vetëm dëshmia biblike e Jezu Krishtit. Luther e përktheu Biblën nga gjuha hebraishte dhe greqishte në gjuhën gjermane dhe e bëri atë të mundshme, të arritshme për njerëzit. Në vitin 1534 kisha shtetërore anglikane doli krejtësisht e pavarur.

Cila ishte gjendja e Krishtëritimit në shek. 19?

Në shek. 19 u ndërmorën përpjekje për të fituar përsëri shumë njerëz, të cilët, për shkak të varfërisë dhe pasigurisë së madhe, e kishin humbur besimin e krishterë si dhe lidhjen me Ungjillin („Mision i brendshëm“). Për më tepër u krijuan „shoqëritë misionare“: ato u kujdesuan për një përhapje të mëtejshme të Krishtëritimit jashtë vendeve, jashtë kufijve të Evropës, e mbi të gjitha në Afrikë.

Çfarë zhvillimesh të rëndësishme pati Krishtërimi i shek. 19?

E një rëndësie të madhe – para së gjithash brenda për brenda Protestantizmit në Angli dhe USA – ishin të ashtuquajturat „lëvizjet për ringjallje“: Besimtarë të krishterë bënë thirrje

që të ktheheshin përsëri nga një „Krishtërim rutinë, i zakonit“, në një besim të gjallë të krishterë. Kjo thirrje për një reflektim sipas Ungjillit lidhej shpesh me shpresën në rikthimin e Krishtit. Ky është sfondi historik, para se Perëndia të përgatiste rifunksionimin e apostujve.

Si ndodhi që në shek. 19 të vendosej përsëri posti i Apostujve?

Ndërmjet viteve 1826 dhe 1829 u mbledhën për një konferencë në Albury (Anglia e Jugut) disa njerëz besimtarë për t'u marrë me Apokalipsin, me Zbulesën e Gjonit. Këto konferenca erdhën si rezultat i ftesës që bëri bankieri Henry Drummond (1786 - 1860) në bashkëpunim të ngushtë me Edward Irving (1792 - 1834), i cili ishte kapelan, kujdestar shpirtëror i kishës nacionale skoceze. Pjesëtarët e konferencës donin të arrin qartësi rreth thënieve, rreth deklaratave biblike për veprimin e Shpirtit të shenjtë si dhe për ardhjen e Krishtit. Edhe në Skoci prisnin besimtarë të feve, të besimeve të ndryshme një veprim, një efekt të fortë të Shpirtit të shenjtë. Ndër ta erdhën në vitin 1830 edhe shumë shërues të dëgjuar sëmundjesh, njerëz që flisnin në gjuhë të panjohura dhe folës me fjalë të urta, të mënçura. Në Vjeshtën e vitit 1832 në Londër u thirr nga Shpirti i shenjtë në shërbim, në detyrë John Bate Cardale (1802 - 1877) dhe nëpërmjet Henry Drummond u cilësua Apostul. Mbas Shtatorit të vitit 1833 u thirrën në detyrë edhe njëmbëdhjetë apostuj të tjerë – mbi të gjitha nëpërmjet profetit Oliver Taplin (1800 - 1862).

Si u krijua kisha Katolike-apostolike?

Në vitin 1835 të gjithë apostujt u mbledhën së bashku për një vit në Albury për të intensivuar këshillimet, udhëzimet e përbashkëta. Ata punuan „Testimonium-in e madh“ dëshminë e madhe (1837), një shkrim pohues, dëshmuar, i cili iu bë i njohur, iu vu në dispozicion të gjithë drejtuesve shpirtërorë dhe botërorë të Krishtërimit. Në këtë Testimonium apostujt i kërkuan të gjithë të krishterëve të mbledheshin nën drejtimin, nën udhëheqjen e tyre, me qëllim që të përgatiteshin për ardhjen e Krishtit. Pra, nuk donin të krijonin ndonjë kishë të re, përkundrazi, donin të mbledhnin nën drejtimin e apostujve të gjithë kishat e atershme. E megjithatë shumica e të krishterëve nuk e ndoqi thirrjen e apostujve. Ata të

krishterë të paktë, të cilët besuan tek apostujt, u mbledhën së bashku në një kishë të re, e pikërisht në kishën Katolike-apostolike.

Si u krijua Kisha Apostolike e Re?

Më 10 Tetor 1862 në Königsberg u emërua nga profeti Geyer, i quajtur Apostel, prifti Rudolf Rosochacky (1815 - 1894), si drejtues i bashkësisë katolike-apostolike. Apostujt e kishës Katolike-apostolike nuk e njohën këtë thirrje, këtë emërim. Profeti Heinrich Geyer dhe drejtuesi i bashkësisë katolike-apostolike në Hamburg, Friedrich Wilhelm Schwartz (1815 - 1895), qenë të bindur, se ai emërim, ai vendim ishte krejtësisht një vepër e Shpirtit të shenjtë. Bashkësia e Hamburg-ut e njohu dhe e pranoi këtë si apostul më 4 Janar 1863 dhe për pasojë u nda, u largua nga kisha Katolike-apostolike. Janari i vitit 1863 shënon fillimin e Kishës Apostolike të Re. Edhe kur pak kohë më vonë Apostel Rosochacky tërhiqet nga detyra, profeti Geyer, drejtuesi i bashkësisë Schwartz dhe bashkësia e Hamburgut besonin plotësisht se atje bëhej fjalë për një thirrje, për një veprim hyjnor.



Photo: Peter Johannning



Foto 1: Juara me familjen e saj, Mami Elda, babi Elton dhe vëllai Sion

Foto 2: Juara me vëllanë e saj të vogël, Sion

Foto 3: Juarës i pëlqen të vizatojë

Foto: NAK Shqipëri

| Prezantimi Juara Demollari

Emri im është Juara. Kam lindur në Tiranë dhe jetoj në Tiranë. Unë jam shtatë vjeçe. Familja ime përbëhet nga babai im, Elton, mamaja ime Elda dhe vëllai im Sion. Sapo kam filluar klasën e parë. Është shumë bukur në shkollë, sepse kam njohur shoqe dhe shokë të rinj. Gjatë kohës së lirë unë luaj së bashku me shoqet e pallatit tim. Bëjmë lojra të ndryshme, organizojmë sfilata mode.

Më pëlqejnë kafshët, (por kam frikë prej tyre) dhe bimët. Më pëlqen shumë të vizatoj, prandaj prindërit e mi më kanë blerë ngjyra dhe bojra të ndryshme. Unë shkoj në Kishën Apostolike të Re në Tiranë. Ajo është ndërtuar në vitin 1998. Është një kishë e thjeshtë dhe shumë e bukur. Unë vij me qejf të dielave në kishë. Kisha sapo është lyer nga brenda dhe mua më pëlqen shumë. Unë marr pjesë në shkollën e së dielës. Atë e drejton mësuese Elda.

Ajo tani po na mëson instrumentin e fyellit. Para disa kohësh ne luajtëm nja dy pjesë me fyell. Ishte një diçka shumë e bukur. Këtë e bëja për herë të parë. Babi im

shërben si prift në këtë bashkësi. Pas shërbesave ne shkojmë tek gjyshërit e mi, që banojnë jo shumë larg nesh. Aty unë kënaqem shumë. Gjyshja ime Ervehe më nxjerr shëtitje, më ëmbëlson me ëmbëlsira, që i gatuan vetë. Ajo më gatuan shumë gjëra të mira, por mua më pëlqejnë thjerrezat dhe pastiçja. Ato nëna i gatuan në mënyrë fantastike. Ajo më blen edhe suflaqe, të cilat I kam shumë qejf.

Ndërsa gjysh Bashkimi më merr here pas here nga shkolla me biçikletë. Dhe rrimë bashkë deri sa prindërit e mi vijnë nga puna. Ai shpeshherë më blen patatina ose suflaqe. Ato i kam shumë qejf. Me origjinë jam nga Korça, se edhe prindërit e mi nga Korça janë. Sa herë që shkoj në fshatin Pojan, nëna ime, të cilën e thërras nëna Dyshi, më gatuan gjëra shumë të shijshme. Por ushqimet, që mua më pëlqejnë shumë dhe që i ha me shumë qejf, janë lakrori dhe petullat në plloçë. Ato nëna ime i gatuan shumë mirë. Ato kanë një shije shumë të shijshme. Mamaja ime Elda kujdeset shumë për vëllanë tim Sion, i cili është i vogël. Prandaj unë përpiqem ta ndihmoj mamën tim në shtëpi.



Foto: NAK Shqipëri

4

Foto 4: Juara në kohën e lirë

Foto 5: Juarës i pëlqen shumë të dalë në natyrë

Foto 6: Juara Demollari

Foto 7: Juara me gjyshe Ervehenë dhe gjysh Bashkimin



5



6

Para disa kohësh ne ishim në fshatin Shën Gjergj. Aty u organizua për here të parë shërbesa fetare në natyrë e mbajtur nga Apostulli Gamov. Aty u kënaqëm shumë, luajtëm me fëmijët e tjerë buzë lumit, luajtëm me top, me litar, bëmë shumë fotografi. Ajri ishte shumë i pastër. Ushqimi ishte shumë i mirë. Gjithçka ishte organizuar nga xhaxhi Jürgen, teta Rosmarie dhe nga xhaxhi Fatmiri. Aty ne kënduam dhe kërcyem. Ndërsa në Tiranë koha ishte shumë e nxehtë, aty ne ndjenim vetëm freski. Atë ditë kaluam një paradite shumë të bukur dhe të këndshme. Do të doja të organizoheshin gjëra të tilla edhe në të ardhmen.

Shkolla më pëlqen shumë, sepse unë mësoj shumë gjëra të bukura. Para disa ditësh festova festën e abetares. Aty recituam dhe kënduam. Kishin ardhur edhe tre kllounë, që i dhanë lezet festës sonë. Kishin ardhur edhe shumë prindër të shokëve dhe shoqeve të mia. Në festë erdhën edhe prindërit e mi. Babi më bëri shumë fotografi dhe mori në kamera të gjithë festën. Në fund kërcyem vallen e Tropojës dhe vallen Pogonishte. Të dyja këto valle më pëlqejnë jashtëzakonisht shumë. Sepse kërcimin e kam shumë qejf. Më erdhi keq, që u ndava nga abetarja, sepse nga ajo mësova të lexoja dhe të shkruaja. Por gjëra më të bukura do të më soj në të ardhmen, sepse shkolla na mëson më të mirën dhe më të vlefshmen për të ardhmen tonë.



7



Pasqyra

03.07.2016	Vancouver/Kanada
09.07.2016	Tiranë/Shqipëri
10.07.2016	Tiranë/Shqipëri
15.07.2016	Tshikapa/RD e Kongos
17.07.2016	Kananga/ RD e Kongos
22.07.2016	Kampala/Uganda
24.07.2016	Kampala/Uganda
07.08.2016	Leipzig/Gjermani
14.08.2016	Heilbronn/ Gjermani
11.09.2016	Innsbruck/Austri
18.09.2016	Krefeld/ Gjermani
24.09.2016	Gramado/Brazil

